



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 04.07.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “EFIÇENCA ENERGJETIKE PËRMES SEKTORIT BANKAR”, RATIFIKUAR ME LIGJIN 89/2015”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca Energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin 89/2015”, në mbledhjen e datës 4 Korrik 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Qëllimi i këtij projektligji është denoncimi i marrëveshjes së bashkëpunimit financiar 2010, të nënshkruar më 6.7.2015, për projektin: “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin 89/2015, ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, me synim tërheqjen nga marrëveshja, e cila vlerësohet të jetë e pazbatueshme dhe, në këtë mënyrë, t’i hapet rrugë nënshkrimit të një marrëveshjeje të re për mbështetjen e projektit “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes Fondit të Garancisë së Kredive Rurale” dhe kalimin e fondeve që nuk janë zbatuar në mbështetje të projektit “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes këtij Fondi.

Projektet e miratuara me ligjin 98/2015 parashikonin vënien në dispozicion të fondeve për kredi nga ana e KFW-së, për bankat shqiptare, për të promovuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Por, nëpërmjet një note verbale, në vitin 2017, Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë sqaron se për shkak të likuiditetit të lartë në sektorin financiar shqiptar rezultoi që kjo nismë nuk ishte efiçente për bankat shqiptare dhe se pengesa më e madhe për dhënien e kredive nuk ishte mungesa e mjeteve financiare, por mungesa e garancive nga ana e kredimarrësve. Për këtë arsye ishte e nevojshme ndërhyrja e Fondit të Garancisë së Kredive Rurale (RCGF), duke vënë në dispozicion të bankave dhe biznesit garanci si dhe duke mundësuar dhënie kredie për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Nga negociimi i Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë dhe të KFW-së me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2017, palët kanë rënë dakord se është e nevojshme të bëhet një riprogramim i marrëveshjes.

Nisur nga ndryshimi i kushteve të përgjithshme, objektivi i promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme tashmë do të të realizohet nëpërmjet një instrumenti tjetër, atij të Fondit të Garancisë së Kredive Rurale (RCGF).

Për t'i hapur rrugë këtij riprogramimi është e nevojshme që palët të tërhiqen nga marrëveshja ekzistuese nëpërmjet instrumentit ligjor të denoncimit, me qëllim negociimin dhe miratimin e një marrëveshje të re, sipas termave të dakordësuara.

Me anë të marrëveshjes që do të denoncohet do të vihet në dispozicion financimi në formën e huas, në vlerën 12 milionë euro, ndërsa marrëveshja e re, që do të lidhet për projektin në fushën e bujqësisë, do të mundësojë një financim në formën e grantit, në vlerën 5 milionë euro.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk morën pjesë në votim.

RELATOR

KRYETAR

Dritan BICI

Eduard SHALSI